UDHËZIM
Nr. 6, datë 27.2.2014

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për TVSH-në" bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 20 "Rimbursimi i TVSH-së", pika 20.1 dhe pika 20.2 rishkruhen si më poshtë:

20. Rimbursimi i TVSH-së

Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, rimbursimi i TVSH-së kryhet nga sistemi i Thesarit. Afatet e përcaktuara për rimbursimin e TVSH-së sipas kategorive të personave të tatueshëm fillojnë nga data e protokollimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së, në Drejtorinë Rajonale Tatimore, datë e cila është e njëjtë me datën e mbërritjes ose paraqitjes së kërkesës për rimbursim nëpërmjet shërbimit postar rekomande (me nënshkrim të marrësit).

20.1 Rimbursimi i personave të tatueshëm

20.1.1 Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 50 të ligjit, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së. Për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së, personi i tatueshëm, pasi të ketë plotësuar rubrikën përkatëse "Kërkesë për rimbursim të TVSH-së", të formularit të deklarimit të TVSH-së të periudhës së fundit tatimore, dërgon në Drejtorinë Rajonale Tatimore:

a) Një kërkesë me shkrim me objekt "Kërkesë për rimbursim të TVSH-së", në të cilën specifikohen të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm, emri i administratorit/ët, adresën/at e saktë të veprimtarisë, degën e bankës dhe numrin e llogarisë bankare të personit të tatueshëm, një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë dhe arsyet e krijimit të TVSH-së kreditore, periudhën përgjatë së cilës është krijuar TVSH-ja kreditore, si edhe nëse kërkesa për rimbursim është për herë të parë apo jo. Nëse personi i tatueshëm që kërkon rimbursimin e TVSH-së është eksportues, kjo shprehet në kërkesën e paraqitur;

b) Formularin "Kërkesë për rimbursim" sipas modelit bashkëngjitur udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 "Për TVSH-në", i ndryshuar.

Drejtoria Rajonale Tatimore, me marrjen e kërkesës për rimbursim, protokollon kërkesën në regjistrin e protokollit dhe brenda ditës së nesërme e regjistron atë në një regjistër të veçantë për rimbursimet e TVSH-së, sipas rendit kronologjik të datës së paraqitjes së kërkesës.

Ky regjistër mbahet nga një punonjës i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i caktuar si person përgjegjës për të mbajtur dhe administruar regjistrin e rimbursimeve nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore.

20.1.2 Punonjësi i ngarkuar me mbajtjen dhe administrimin e regjistrit të rimbursimeve, brenda 3 (tri) ditëve punë, nga data e regjistrimit në regjistrin e rimbursimeve, kryen dhe përfundon procesin e verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim në lidhje me:

a) Të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm (emri tregtar, NIPT-i, ortaku/ortakët, administratori/ administratorët, llojin e veprimtarisë, numrin e llogarisë bankare ku kërkohet të bëhet rimbursimi, adresën(-at) e vendndodhjes së veprimtarisë, evidentimin nëse kërkesa për rimbursim është për herë të parë apo kërkesë e përsëritur, si dhe të dhëna të tjera të dosjes së personit të tatueshëm;

b) Verifikimin e shumës së paraqitur në formularin "Kërkesë për rimbursim", nëse ajo është e barabartë me shumën e paraqitur në rubrikën përkatëse të FDP-së të muajit korrespondues, si dhe periudhën për të cilën është kërkuar rimbursimi;

c) Plotësimin e kërkesave ligjore mbi kërkesën për rimbursim, të cilat konsistojnë në:

i) Për personat e tatueshëm të përcaktuar eksportues sipas VKM-së për këtë qëllim, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse teprica kreditore e kërkuar për rimbursim është e barabartë ose më e madhe se 400.000 lekë;

ii) Për personat e tatueshëm të tjerë joeksportues, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse personi i tatueshëm ka mbartur tepricë kreditore të TVSH-së për të paktën 3 periudha tatimore radhazi dhe kjo tepricë është e barabartë ose më e madhe se 400.000 lekë;

iii) Në rastet e parashikuara në pikën 3 të nenit 50 të ligjit, nëse kërkesa për rimbursim është bërë në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar.

Në përfundim të këtij procesi, personi përgjegjës mban një akt për evidentimin e plotësimit ose jo të kritereve të mësipërme.

20.1.3 Kërkesa për rimbursim konsiderohet e papranuar nëse nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim, nuk janë plotësuar kriteret e përgjithshme si në pikën 20.1.2, ose e pranuar nëse këto kritere janë plotësuar.

a) Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton se kriteret nuk janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e parregullt dhe nuk pranohet. Në këtë rast, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe me administrimin e kërkesave për rimbursim, brenda 2 (dy) ditëve punë nga përfundimi i procesit të verifikimit, nis nëpërmjet shërbimit postar për

personin e tatueshëm një njoftim me shkrim sipas formatit nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi "Njoftimi për mospranim të kërkesës për rimbursim të TVSH-së", ku i bëhet e ditur se kërkesa e tij nuk është pranuar, duke dhënë njëkohësisht edhe shkaqet e mospranimit. Ky person i tatueshëm, mund të paraqesë një kërkesë të dytë të re për rimbursim sipas rregullave të mësipërme, vetëm pasi të ketë rregulluar situatën dhe të ketë eliminuar shkaqet për të cilat nuk iu pranua kërkesa e mëparshme.

Në këtë rast, personi përgjegjës për mbajtjen e regjistrit, në bashkëpunim me inspektorin e dosjes, bën rivlerësimin e rubrikës përkatëse "Kërkesë për rimbursim të TVSH-së" të deklaratës së periudhës kur kërkesa është bërë, duke hequr vlerën nga rubrika përkatëse dhe automatikisht kjo vlerë kalon si TVSH e mbartur.

b) Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton se kriteret janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e pranuar. Në këtë rast, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe me administrimin e kërkesave për rimbursim, brenda 2 (dy) ditëve punë nga përfundimi i procesit të verifikimit, nis njoftimin për degën përkatëse të Thesarit nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe në formë shkresore). Një kopje e këtij njoftimi i dërgohet edhe personit të tatueshëm. Njoftimi sipas formatit nr. 2 "Njoftim për pranimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së", bashkëlidhur këtij udhëzimi, informon degën e Thesarit se kërkesa e personit të tatueshëm për rimbursim të TVSH-së është pranuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe ky njoftim përmban: i) emrin dhe NIPT-in e personit të tatueshëm; ii) cilësimin nëse subjekti është eksportues ose jo; iii) shumën e kërkuar për rimbursim; dhe iv) datën kur është protokolluar kërkesa në Drejtorinë Rajonale Tatimore sipas paragrafit 20.1.1. Ky njoftim nënshkruhet nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Për rastin "b", në ditën në të cilën kërkesa konsiderohet e pranuar, ajo adresohet për kontroll në vend, të personit të tatueshëm. Radha e kontrollit ndjek, në çdo rast dhe pa asnjë përjashtim, radhën kronologjike të paraqitjes së kërkesave për rimbursim të TVSH-së. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, në përputhje me procedurën e kontrollit, lëshon njoftimin për kontroll tatimor në vend të personit të tatueshëm, ku jepet data e fillimit dhe e përfundimit të kontrollit, inspektori/ët e ngarkuar për kontroll dhe qëllimi i kontrollit, periudhat tatimore për të cilat do të shtrihet kontrolli etj. Procedura e kontrollit në vend kryhet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

20.1.4 Struktura përgjegjëse e degës së Thesarit, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e njoftimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore, sipas pikës 20.1.3/b, e regjistron atë sipas rastit në një regjistër të veçantë të saj, ku regjistron datën e kërkesës për rimbursim të personit të tatueshëm sipas datës së protokollit të kërkesës për rimbursim në Drejtorinë Rajonale Tatimore, si dhe të dhënat e tjera sipas kësaj shkrese. Struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër merr masa për të siguruar likuiditetin e nevojshëm për pagesën e shumës së rimbursimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore brenda 30 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim kur personi i tatueshëm është eksportues i klasifikuar sipas pikës 20.2 të këtij udhëzimi, ose për rastin e marrëveshjeve sipas nenit 50, pika 3 të ligjit, dhe brenda 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim për tastet e tjera të personit të tatueshëm.

Brenda 3 ditëve të para të punës së çdo tremujori, dega e Thesarit rakordon me drejtorinë rajonale tatimore respektive mbi të dhënat e regjistruara nga të dyja institucionet për kërkesat e personave të tatueshëm për rimbursim të TVSH-së.

20.1.5 Punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, paralelisht dhe pavarësisht nga procedura e kontrollit në vend të personit të tatueshëm, në bashkëpunim me punonjësin e dosjes së personit të tatueshëm, kryen verifikimin e situatës financiare të tatimpaguesit në sistemin informatik, por pa u kufizuar vetëm në të, dhe evidenton detyrimet tatimore të papaguara.

Pas përfundimit të kontrollit dhe nxjerrjes së rezultateve përfundimtare, ku saktësohet shuma e TVSH-së për t'u rimbursuar, raporti përfundimtar i kontrollit i përcillet drejtorisë përgjegjëse për përpunimin, vlerësimin e të ardhurave dhe rimbursimin, e cila procedon me kompensimin e detyrimeve tatimore të papaguara, përveç kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Pas saktësimit të shumës së TVSH-së të mbetur pas kompensimit të detyrimeve të papaguara, nëse ka të tilla, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, përgatit njoftimin zyrtar sipas formatit nr. 3 "Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së", bashkëngjitur këtij udhëzimi. Njoftimi i dërgohet me postë rekomande edhe personit të tatueshëm që ka bërë kërkesën për rimbursim të TVSH-së. Ky njoftim përmban, përveç të dhënave identifikuese të personit të tatueshëm, dhe datën e protokollimit të kërkesës për rimbursim, shumën e TVSH-së së kërkuar për rimbursim sipas kërkesës së personit të tatueshëm, shumën e miratuar si të rimbursueshme sipas raportit përfundimtar të kontrollit, shumën e nevojshme të përdorur apo për t'u përdorur (nëse procesi i kompensimit nuk ka përfunduar i plotë brenda afateve) për likuidimin e të gjitha detyrimeve tatimore të papaguara të personit të tatueshëm ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore, si dhe shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet në llogarinë e personit të tatueshëm.

20.1.6 Punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, plotëson urdhër-pagesën për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm dhe të dhëna të tjera sipas formatit nr. 4 të urdhërpagesës bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe së bashku me njoftimin zyrtar në përputhje me formatin nr.

3, sipas pikës 20.1.5, pasi nënshkruhen nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i dërgohen me postë rekomande degës përkatëse të Thesarit në dy kopje.

Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vuloset nga dega e Thesarit, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore. Dega përkatëse e Thesarit, regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë brenda ditës së paraqitjes nga Drejtoria Rajonale Tatimore, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoritë rajonale të tatimeve rakordojnë me degët e Thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të Thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të Thesarit) njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

20.1.7 Kur nga raporti përfundimtar i kontrollit tatimor mbi kërkesën për rimbursim rezulton se shuma e TVSH-së së kërkuar për rimbursim nga personi i tatueshëm nuk plotëson kushtet për rimbursim dhe, për rrjedhojë, nuk rimbursohet, Drejtoria Rajonale Tatimore refuzon kërkesën për rimbursim dhe njofton zyrtarisht degën përkatëse të Thesarit në formatin nr. 5 “Njoftim për refuzimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së” bashkëlidhur këtij udhëzimi nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe në formë shkresore) në dy kopje, njëra prej të cilave, pasi kundërfirmoset dhe vuloset, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore, duke vërtetuar se është bërë çregjistrimi i kërkesës për rimbursim të personit të tatueshëm nga Regjistri i Sistemit të Thesarit.

Ndërkohë mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim, personi i tatueshëm njoftohet me një akt zyrtar, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

20.1.8 Në raste të refuzimit ose të mosmiratimit të një kërkese për rimbursim, plotësisht ose pjesërisht, nga Drejtoria Rajonale Tatimore për arsye që kanë të bëjnë me rezultatet e kontrollit ose me shkelje të tjera ligjore, personi i tatueshëm ndaj çdo refuzimi ose mosmiratimi për rimbursim, ka të drejtë të apelojë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

20.1.9 Të gjitha procedurat e mësipërme, për kryerjen e të cilave ngarkohet Drejtoria Rajonale Tatimore, duhet të kryhen brenda afateve të përcaktuara, përkatësisht 30 ditë për eksportuesit dhe 60 ditë për personat e tjerë të tatueshëm, duke filluar nga data e protokollit të kërkesës për rimbursim në Drejtorinë Rajonale Tatimore. Në rast se organi tatimor përfundon procedurat e kontrollit përpara afatit 30 ditë për eksportuesit dhe 60 ditë për personat e tjerë të tatueshëm, procedura e rimbursimit vazhdon sipas përcaktimeve të bëra në pikën 20.1.6 të këtij udhëzimi.

20.1.10 Procedura e përcaktuar në këtë udhëzim do të zbatohet për të gjitha kërkesat për rimbursim të TVSH-së të protokolluara në drejtoritë rajonale tatimore pas datës 1.1.2014.

20.1.11 Për çdo kërkesë të konsideruar të pranuar, protokolluar pas datës 1.1.2014 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, drejtoritë rajonale tatimore, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, njoftojnë degën përkatëse të Thesarit me anë të njoftimit sipas formatit nr. 2 “Njoftim për pranim të kërkesës për rimbursim”, dhe vijojnë procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

20.2 Rimbursimi i personave të tatueshëm eksportues

Në zbatim të nenit 50, paragrafi 4 dhe 5 të ligjit për TVSH-në, rimbursimi i TVSH-së të personave të tatueshëm eksportues kryhet nëpërmjet sistemit të Thesarit sipas procedurës së përcaktuar në këtë udhëzim. Klasifikohen “eksportues” ata persona të tatueshëm që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Klasifikimi i personave të tatueshëm eksportues me risk zero, bëhet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve në të cilën ato janë regjistruar, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

20.2.1 Për personat e tatueshëm të klasifikuar si eksportues me risk zero, kontrolli tatimor në vend nuk është i detyrueshëm përpara miratimit të rimbursimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore. Për këtë kategori të eksportuesve, kontrolli tatimor mund të kryhet në çdo moment sipas planifikimit për kontroll.

Në rastin kur personi i tatueshëm eksportues ka plotësuar kriteret e përgjithshme për rimbursim sipas pikës 20.1.1 dhe 20.1.2, kërkesa konsiderohet e pranuar. Në këtë rast, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe me administrimin e kërkesave për rimbursim, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e përfundimit të procesit të verifikimit, nis njoftimin për degën përkatëse të Thesarit nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe në formë shkresore). Ky njoftim sipas formatit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, “Njoftim për pranim të kërkesës për rimbursim”, informon degën e Thesarit se personi i tatueshëm ka paraqitur një kërkesë të rregullt për rimbursim të TVSH-së. Në të njëjtën kohë, njoftimi zyrtar i përgatitur sipas formatit nr. 2 (i dërgohet me postë rekomande edhe personit të tatueshëm, eksportues me risk zero që ka bërë kërkesën për rimbursim të TVSH-së).

Në vijim të procedurës brenda, afatit 30-ditor, i cili fillon me datën e protokollit të kërkesës për rimbursim, Drejtoria Rajonale Tatimore, pasi verifikon dhe kompenson detyrimet tatimore të papaguara (nëse ka të tilla), përveç kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përgatit njoftimin sipas formatit nr. 3 “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së”. Këtë njoftim, së bashku me urdhër-pagesën për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm dhe të dhëna të tjera sipas formatit nr. 4 të urdhërpagesës, pasi nënshkruhen nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore,

i dërgohen me postë rekomande degës përkatëse të Thesarit në dy kopje.

Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vuloset nga dega e Thesarit, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore. Dega përkatëse e Thesarit, regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë brenda ditës së paraqitjes nga Drejtoria Rajonale Tatimore, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoritë rajonale të tatimeve rakordojnë me degët e Thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare për detyrimin tatimor lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të Thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të Thesarit) njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

20.2.2 Për kategoritë e tjera të eksportuesve sipas VKM-së, rimbursimi kryhet sipas procedurave të zakonshme të përshkruara në pikën 20.1 të këtij udhëzimi, pasi shuma e kërkuar për rimbursim i është nënshtruar një kontrolli tatimor në vend.

Rimbursimi i TVSH-së së miratuar kryhet nga dega e Thesarit nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë. Në përfundim të procedurave me miratimin e TVSH-së së rimbursueshme, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, plotëson urdhër-pagesën për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm eksportues dhe të dhëna të tjera sipas formatit të urdhërpagesës bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe së bashku me njoftimin zyrtar të përgatitur sipas 20.1.5, pasi nënshkruhen nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore i dërgohen dorazi degës përkatëse të Thesarit në dy kopje. Në të njëjtën kohë, njoftimi zyrtar i përgatitur sipas pikës 20.1.5, i dërgohet me postë rekomande edhe personit të tatueshëm që ka bërë kërkesën për rimbursim të TVSH-së.

Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vuloset nga dega e Thesarit, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore. Dega përkatëse e Thesarit regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë brenda ditës së paraqitjes nga Drejtoria Rajonale Tatimore, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoritë rajonale të tatimeve rakordojnë me degët e Thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare për detyrimin tatimor lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të Thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të Thesarit) njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

20.3 Rimbursimi për marrëveshjet financiare

Në zbatim të pikës 3 të nenit 50 të ligjit "Për TVSH-në", për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar, u rimbursohet financuesve të huaj brenda 30 ditëve nga strukturat përgjegjëse të Thesarit (sipas rregullave në pikën 20.1 të këtij udhëzimi) nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë), sipas rregullave të përcaktuara më poshtë në këtë udhëzim. Për rimbursimin e kryer sipas kësaj procedure, kontrolli tatimor në vend nuk është i detyrueshëm përpara rimbursimit.

Çdo procedurë për rimbursimin apo financimin e TVSH-së për rastet e mëposhtme pavarësisht nëse kryhen nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve apo financohen sipas procedurave të VKM-së nr. 509, datë 12.8.1996, nga përfituesi vendas, do të përfundojë brenda 30 ditëve përfshirë edhe rimbursimin e shumave nga strukturat përgjegjëse të Thesarit.

20.3.1 Kur pavarësisht përjashtimit, TVSH-ja përballohet (paguhet) direkt nga donatori.

a) Kur projekti realizohet (zbatohet) nga vetë njësia zbatuese.

Njësia zbatuese e projektit për qëllime të rimbursimit të TVSH-së sipas nenit 50 pika 3 të ligjit, duhet të pajiset me NIPT (certifikatë regjistrimi) në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me këtë ligj. Njësia zbatuese e projektit çregjistrohet në përfundim të afatit të projektit. TVSH-ja mbulohet (përballohet) direkt nga njësia zbatuese e donatorit apo e projektit në Shqipëri si për blerjet brenda vendit ashtu dhe për importet, njësia paraqet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku ka qendrën njësia zbatuese e projektit, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim etj.

- Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

- Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH-së që kërkohet të rimbursohet.

- Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat doganore të importit, duhet të përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin "Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr. __, datë __/ __/ 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje". Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit, i njohur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në bazë të listës së

mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

b) Kur projekti realizohet nga sipërmarrës të kontraktuar nga njësia zbatuese.

Në këtë rast, në kuadër të zbatimit të projektit, është shoqëria sipërmarrëse e punimeve, e cila për zbatimin e projektit sipas kontratës aplikon TVSH-në mbi vlerën e punimeve, shërbimeve apo furnizimit të mallrave të kryer. Shoqëria sipërmarrëse nga TVSH-ja e faturuar zbret TVSH-në e paguar në blerjet që ka bërë për këtë qëllim, të përballuar nga vetë ajo dhe diferenca përfaqëson TVSH-në e pagueshme nga kjo shoqëri, TVSH-ja, e cila deklarohet dhe paguhet sipas këtij ligji. Faturën origjinale të shitjes, së bashku me situacionin e punimeve, shoqëria sipërmarrëse e punimeve ia paraqet njësisë zbatuese të projektit.

Njësia zbatuese e projektit, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së sipas nenit 50, pika 3 të ligjit, duhet të pajiset me NIPT (certifikatë regjistrimi) në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me këtë ligj. Njësia zbatuese e projektit çregjistrohet në përfundim të afatit të projektit. Njësia zbatuese e projektit paraqet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku është e regjistruar, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim etj.

- Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

- Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH-së që kërkohet të rimbursohet.

- Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat doganore të importit, duhet të përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin "Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr. __, datë __/ __/ 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje". Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit, i njohur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në bazë të listës së mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

20.3.2 TVSH-ja përballohet nga përfituesi vendas i projektit si kosto lokale.

Kryerja e punimeve, furnizimi i mallrave apo i shërbimeve për zbatimin e projekteve do të ngarkohet kurdoherë me TVSH, e cila në çdo rast do të paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e kontraktuar për zbatimin e projektit. Por kjo TVSH do t'i jepet atij përkundrejt paraqitjes së fatures (situacionit) me TVSH nga burime të brendshme të financuara nga kosto lokale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996. Kështu, kur donatori nuk merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së, do të veprohet në përputhje me VKM-në nr. 509, datë 12.8.1996. Në bazë të këtij vendimi, TVSH-ja financohet nga përfituesi apo investitori vendas i projektit dhe paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.

2. Pika 20.3, që fillon me fjalinë: "Në rastin e zbatimit të marrëveshjeve kuadër "Mbi bashkëpunim dhe zhvillim"", midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, …….., ndryshon renditjen dhe bëhet pika 20.4.

3. Pika 20.4, që fillon me fjalinë: "Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)" ……..", ndryshon renditjen dhe bëhet pika 20.5.

Në këtë pikë, pas fjalisë "Drejtoria Rajonale Tatimore regjistron në një regjistër të veçantë të tilla OJF për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të këtyre projekteve dhe lëshon për OJF-të një certifikatë të regjistrimit të projektit për efekt të rimbursimit të TVSH-së" shtohen fjalët "sipas formatit nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

4. Pika 20.4, e cila fillon me fjalinë: "Në rastet e zbatimit të marrëveshjeve kuadër për bashkëpunim dhe zhvillim, në bazë të të cilave përfitues janë institucionet buxhetore, të cilave në momentin e importimit nuk iu janë livruar nga Drejtoria e Thesarit...", ndryshon renditjen dhe bëhet pika 20.6.

5. Në pikën 8.6 të udhëzimit, paragrafi i parafundit, i cili fillon me fjalinë: Pas verifikimit dhe miratimit të kërkesave për rimbursim, ... , ndryshon si më poshtë:

"Pas verifikimit dhe miratimit të kërkesave për rimbursim, Drejtoria Rajonale Tatimore i dërgon degës së Thesarit urdhërpagesën për rimbursim të TVSH-së sipas formatit nr. 4 bashkëngjitur këtij udhëzimi, për të gjithë shumën e TVSH-së që do të rimbursohet në bazë të kërkesave të paraqitura nga Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Dega përkatëse e Thesarit, në bazë të kësaj urdhërpagese, kalon për drejtorinë përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme të gjithë shumën e TVSH-së së rimbursueshme. Kjo e fundit shpërndan rimbursimet sipas çdo kërkese.".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr._____ prot. *Datë ...../...../.....*
(Formati nr. 1)

NJOFTIM PËR MOSPRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH-së

Drejtuar: **Subjektit "_____"**
Z. _____

NIPT: _____

Adresa: _____

Në përgjigje të kërkesës suaj, protokolluar me tonën me nr. _____, datë _____, me anë të së cilës keni kërkuar rimbursimin e TVSH-së për shumën _____ lekë _____ (shuma në fjalë), për periudhën _____, bazuar në:

- Ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, neni 50;
- Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, pika 20;

Ju njoftojmë se për mosplotësim të _____ *(arsyet e mospranimit)*_____,

_____

_____

Kërkesa juaj për rimbursim të TVSH-së nuk është pranuar nga administrata tatimore.
Pasi të keni rregulluar situatën dhe të keni plotësuar kërkesat e përcaktuara në dispozitat e sipërpërmendura, ju mund të paraqisni një kërkesë të re për rimbursim.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

D R E J T O R I

_____

Ky njoftim i dërgohet personit të tatueshëm nëpërmjet shërbimit postar, brenda 5 ditëve pune nga data e protokollit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së.
Ky njoftim, formati nr. 1, është miratuar me udhëzimin e ministrit të Financave nr. ....., datë .....2014.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr._____prot. *Datë ...../...../.....*

(Formati nr. 2)

NJOFTIM PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH-së

Drejtuar: **DEGËS SË THESARIT _____**

Për dijeni: ***Subjekti:* _____**
***Z.* _____**
***Adresa:* _____**

Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 "Për TVSH-në", të ndryshuar, pika 20, ju informojmë se është pranuar kërkesa për rimbursim e personit të tatueshëm me të dhënat:

Emri i personit të tatueshëm:	_____
Numri i identifikimit i personit të tatueshëm NIPT/NUIS:	_____
Emri, mbiemri (administratori/drejtori)	_____
Adresa:	_____
Qyteti/komuna/rrethi:	_____
Nr. i telefonit, e-mail:	_____
Kërkesa për rimbursim nr. prot.	_____
Datë:	_____

Eksportues: [1)]	
Marrëveshje financiare:	
Shuma e kërkuar në numër dhe fjalë:	
Periudha:	
Dega e bankës/nr. i llogarisë bankare:	

D R E J T O R I

_____

Shënime

1. Kjo rubrikë plotësohet nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM-së nr_____, datë_____ "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të TVSH-së". P.sh. (eksportues me risk zero/eksportues të tjerë).
- Ky njoftim i dërgohet degës së Thesarit nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe në formë shkresore), brenda 5 ditëve pune nga data e protokollit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së.
- Ky njoftim është i vlefshëm vetëm për njoftimin e fillimit të procedurës së rimbursimit dhe jo për ekzekutimin e rimbursimit. Në rast miratimi, ky njoftim do të pasohet me formatin nr. 3, ku përcaktohet shuma për t'u rimbursuar.
- Ky njoftim, formati nr. 2, është miratuar me udhëzimin e ministrit të Financave nr. ....., datë..../... /2014.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr._____prot. *Datë ...../...../.....*

(***Formati nr. 3)***

<u>NJOFTIM PËR MIRATIMIN E RIMBURSIMIT TË TVSH-së</u>

Drejtuar: **DEGËS SË THESARIT** _____

Për dijeni: ***Subjekti:*** _____
Z. _____
Adresa: _____

Në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, neni 50, udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 "Për TVSH-në", të ndryshuar, pika 20, ju njoftojmë për rimbursimin e TVSH-së së personit të tatueshëm si më poshtë:

Emri i personit të tatueshëm:	
Numri i identifikimit i personit të tatueshëm NIPT/NUIS:	
Emri, mbiemri (administratori/drejtori)	
Adresa:	
Qyteti/komuna/rrethi:	
Nr. i telefonit, e-mail:	
Kërkesa për rimbursim nr. prot.	
Datë:	
Eksportues: [1)]	
Marrëveshje financiare:	
Dega e bankës/nr. i llogarisë bankare:	

Shuma e kërkuar për rimbursim ……..…… ……..…… .[1]
(Shuma sipas kërkesës së subjektit)
Shuma e miratuar për rimbursim ...…… ……..[2]

(Shuma e miratuar si e rimbursueshme sipas raportit përfundimtar të kontrollit)

Shuma e përdorur/ mbajtur për kompensim të detyrimeve tatimore.....……..[3]

Shuma e TVSH-së për t'u rimbursuar ([2] - [3]) ……...[4]

(Shuma që do të kalojë nga thesari në llogarinë bankare të subjektit)

DREJTORI

(nënshkrimi dhe vula)

Shënime

1. Kjo rubrikë plotësohet vetëm nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM-së nr_____, datë_____ "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të TVSH-së", p.sh. (eksportues me risk zero/eksportues të tjerë).

- Ky njoftim (formati nr. 3) përgatitet të paktën në 5 kopje, 2 prej të cilave i dërgohen Thesarit; 1 kopje i dërgohet subjektit; 1 kopje në dosjen e tatimpaguesit dhe 1 kopje në zyrën e protokollit.

- Ky njoftim është i vlefshëm për ekzekutimin nga dega e Thesarit të rimbursimit të TVSH-së së miratuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore.

- Këtij njoftimi i bashkëngjitet urdhërpagesa (UPR) sipas formatit të miratuar sipas këtij udhëzimi dhe i dërgohet në 2 kopje degës së Thesarit. Njëra kopje nga të cilat pasi kundërfirmohet dhe vuloset nga dega e Thesarit, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore.

- Ky njoftim pa UPR i dërgohet me postë rekomande edhe personit të tatueshëm, që ka bërë kërkesën për rimbursim të TVSH-së.

- Të gjitha shumat në këtë njoftim, përveçse në numër, duhet të shkruhen dhe me fjalë.

- Ky njoftim, formati nr. 3, është miratuar me udhëzimin e ministrit të Financave nr. ....., datë ..../.../2014.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE

Nr._____prot. *Datë ...../...../.....*

(Formati nr. 4)

Emërtimi i institucionit	**Drejtoria Rajonale e Tatimeve**
NIPT-i	**xxxxxxxxxx**
Kodi i institucionit	**1010xxxx**
Entiteti i qeverisjes	**001**
Rrethi	**xxxx**

Nr. i kuponit

URDHËRPAGESË RIMBURSIMI PËR TVSH-në

Nr. **Datë** __.__.20__

Nr.	**Struktura e llogarive_kodi**						**SHUMA në lekë**	**Objekti i pagesës**
	Institucioni	**Kapitulli**	**Programi**	**Llogaria ekonomike**	**Nënllogaria**	**Kodi i projektit**		
1								
2								
3								
TOTALI ME SHIFRA							**xxx,xxx.xx**	**X**
TOTALI ME FJALË							(……..)	

IBAN: AL

Të dhëna për subjektin përfitues:	
Emri i subjektit përfitues	
NIPT - i	
Nr. i llog. bankare të subjektit	
Emri i bankës	
Adresa e bankës	
xxxxxx (p.sh. Tiranë)	

Dokumentet ngjitur urdhërpagesës së rimbursimit:		
Emërtimi	**Nr. i dokumentit**	**Data e dokumentit**
Njoftimi	nr. xxx	datë __,__,20__
Të tjera (emërtime, numër, datë)		

PËR DREJTORINË RAJONALE TATIMORE _____

PËR DEGËN E THESARIT

Aprovuar datë

DREJTORI I DREJTORISË RAJONALE (_____) **Vula**

DREJTORI I DR. VLERËSIMIT/KONTABILITETIT (_____)

DREJTORI I DEGËS SË THESARIT (_____) **Vula**

Shënim: Qelizat për "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar datë", plotësohen nga nëpunësi i degës së Thesarit

Ky njoftim, formati nr. 4, është miratuar me udhëzimin e ministrit të Financave nr ....., datë..../... /2014.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr._____prot. *Datë ...../...../.....*

(Formati nr. 5)

NJOFTIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH-së

Drejtuar: DEGËS SË THESARIT _____

Në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për TVSH-në", të ndryshuar, nenit 50, udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 "Për TVSH-në", të ndryshuar, pika 20, ju njoftojmë se ***është refuzuar*** kërkesa për rimbursim e personit të tatueshëm me të dhënat:

Emri i personit të tatueshëm:	
Numri i identifikimit i personit të tatueshëm NIPT/NUIS:	
Emri, mbiemri (administratori/drejtori)	
Adresa:	
Qyteti/komuna/rrethi:	
Nr. i telefonit, e-mail:	
Kërkesa për rimbursim nr. prot.	
Datë:	
Eksportues: [1)]	
Marrëveshje financiare:	
Shuma e kërkuar në numër dhe fjalë:	
Periudha:	
Dega e bankës/nr. i llogarisë bankare:	

DREJTORI RAJONAL I TATIMEVE **DREJTORI I DEGËS SË THESARIT**

_____ _____

Shënime. 1. Kjo rubrikë plotësohet nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM-së nr._____, datë_____ "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të TVSH-së". P.sh., eksportues me risk zero/eksportues të tjerë.
- Ky njoftim sipas pikës 20.1.7 informon degën e Thesarit për refuzimin e kërkesës për rimbursim dhe dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave kundërfirmohet, vuloset dhe i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore, duke vërtetuar se është bërë çregjistrimi i kërkesës për rimbursim të personit të tatueshëm nga regjistri i sistemit të Thesarit.
- Ky njoftim, formati nr. 5, është miratuar me udhëzimin e ministrit të Financave nr ....., datë..../... /2014.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr._____prot. *Datë ...../...../.....*

Formati nr. 6

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT TË PROJEKTIT
PËR RIMBURSIMIN E TVSH-së

Drejtuar: **Organizatës jofitimprurëse _____**
NIPT: **_____**
Adresa: **_____**

Për dijeni: **DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI**

Adresa:**_____**

TIRANË

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)", si dhe të pikës 20.5 të udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 "Për TVSH-në", të ndryshuar.

Kjo certifikatë i jepet organizatës jofitimprurëse*…… (emër, NIPT) ……*, sipas aplikimit të saj me kërkesën nr. …….. prot., datë……..…, për regjistrimin për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të projektit…..……..…*(emri i projektit)*……, sipas kontratës së paraqitur (të noterizuar), lidhur midis kësaj organizate dhe delegacionit të KE-së, me afat …… *(afati i realizimit të kontratës)*….. …….. .

Kjo certifikatë me nr. regjistri ……. është e vlefshme deri në përfundim të afatit të përcaktuar në kontratë.

DREJTORI

_____

Shënime

- Kjo certifikatë lëshohet për aplikimin e OJF-ve për rimbursim të TVSH-së për projektin IPA, në zbatim të pikës 20.5 të udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 "Për TVSH-në", i ndryshuar.
- Nr. i regjistrit është numri i regjistrit të veçantë ku DRT-ja regjistron OJF-të për efekt të rimbursimit të TVSH-së.
- Modeli i kësaj certifikate është miratuar me udhëzimin e ministrit të Financave nr. ....., datë ...../..... /2014.